



VENDIM

Nr. 90 Datë 29.06.2012

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “HEC VLUSHE” SH.P.K, PËR LËNIEN PENG TË
ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BANKËS KOMBETARE
TREGETARE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8, të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licensës me seri PV10P, “Për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.06.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të asetëve si kolateral nga shoqëria “HEC VLUSHE” sh.p.k pranë Bankës Kombëtare Tregtare, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC VLUSHE” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 Emri dhe adresa e plote e të licensuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korekte.)
- Neni 7, pika 1.3, gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, Përshkrimi i të licensuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HEC VLUSHE” sh.p.k për lënie peng si kolateral të 100 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI